



Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, **14.07.2022**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.07.2022 të parashtruar nga Grupit të OE **“Lindi Markings”SH.P.K.,& “Beni – Com” Shpk,Vitomirice Kosovë**; lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” Loto 4**, me Nr. të Prok: **616-22-2845-2-1-1** dhe numër të brendshëm 616 22 034 211 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të OE **“Lindi Markings”SH.P.K.,& “Beni – Com” Shpk**; të dt. 13.07.20 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” Loto 4** me **616-22-2845-2-1-1** dhe numër të brendshëm 616 22 034 211 , kundër Vendimit të *Njoftimit të AK* së, të datës: 08/07/2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së
2. AK vendos që ta kthejë në rivlerësim aktivitetin e prokurimit: **“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”** me numër të prokurimit: **616-22-2845-2-1-1** dhe Nr. Brendshëm 616 22 034 211, në mënyrë që komisioni për rivlerësim ta riezaminojë edhe njëher ofertën e grupit të OE **“Grup i Operatorëve Ekonomik Lindi Markings”SH.P.K.,& “Beni – Com” Shpk**; për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim


Grupi i OE **“Lindi Markings”SH.P.K.,& “Beni – Com” Shpk** me datë 13.07.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal”**, me Nr. të Prok: **616-22-2845-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 034 211.**

Autoriteti Kontraktues, me datë 14.07.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

AK gjate vleresimit te ofertave nuk ka marr per baze te gjitha folite e derguara per mostren e ofruar nga grupi i OE por ka marr per baze vetem njeren nga folite e derguara e cila foli nuk eshte derguar sipas kerkesave te kerkuara ne Njoftimin per kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit. AK do ta beje rivleresimin e ofertave, dhe po ashtu duke u bazuar ne nenin 72 te LPP (Dokumentacioni dhe informacioni shtese), do te kerkoj nga Grupi i OE **“Lindi Markings”SH.P.K.,& “Beni – Com” Shpk. sqarime lidhur me pretendimet e cekura nga OE ankues.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më larte ka vendosur si ne dispozitiv. Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij Vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit